

MERITOKRACIA NË KARRIERAT GJYQËSORE

MANUAL TRAJNIMI PËR SHOQËRINË CIVILE

Emërimi i anëtarëve jo-gjyqtarë
të Gjykatës së Lartë

Manual 3

Tiranë, Shtator 2023

Ky botim është bërë i mundur me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian.



Funded by
the European Union

Ky botim është përgatitur në kuadër të projektit “Gjyqësori në fokus” i zbatuar nga një konsorcium prej tre partnerësh: Instituti për Studimet Publike dhe Ligjore (ISPL), Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë (OSFA) dhe Centre for Legal Empowerment (CLE), me mbështetjen e Bashkimit Evropian në kuadër të kornizës “Civil Society Facility and Media Programme 2021”.

Ky botim është bërë i mundur me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian. Përmbajtja e këtij dokumenti është përgjegjësi e vetme e Institutit për Studimet Publike & Ligjore dhe në asnjë rrethanë nuk mund të konsiderohet se pasqyron pozicionin e Bashkimit Evropian.

©Të gjitha të drejtat e botimit i takojnë Institutit për Studimet Publike & Ligjore (ISPL)

ISBN: ?????

SHKURTIME

GjK	Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë
GjL	Gjykata e Lartë
GjEDNj	Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut
KEDNj	Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut
DNJF	Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas
MD	Ministria e Drejtësisë
KL Gj	Këshilli i Lartë Gjyqësor
KLP	Këshilli i Lartë i Prokurorisë
ILD	Inspektorati i Lartë i Drejtësisë
ShM	Shkolla e Magjistraturës
K.Pr.C.	Kodi i Procedurës Civile
K.Pr.P.	Kodi i Procedurës Penale
OJF	Organizata jofitimprurëse

Pasqyra e lëndës

SHKURTIME	3
HYRJE	7
OBJEKTIVAT DHE REZULTATET QË SYNOHEN TË ARRIHEN	9
STRUKTURIMI DHE PËRMBAJTJA E MODULEVE	11
PLANI I TRAJNIMIT.....	12
MODULI 1	
INSTRUMENTET DHE METODOLOGJIA E MONITORIMIT MBI KUSHTET E ZGJEDHSHMËRISË SË ANËTARËVE JO-GJYQTARË TË GJYKATËS SË LARTË	13
Kriteret ligjore.....	13
Objekti i monitorimit të kriterëve ligjore	14
Metodologjia e mbledhjes së të dhënave/informacionit mbi respektimin e kriterëve ligjore.....	14
MODULI 2	
INSTRUMENTET DHE METODOLOGJIA E MONITORIMIT MBI PROCEDURËN E EMËRIMIT TË ANËTARËVE JO-GJYQTARË TË GJYKATËS SË LARTË	15
Procedura e emërimit	15
Objekti i monitorimit për procedurën	15
Metodologjia e mbledhjes së të dhënave për procedurën	16
MODULI 3	
INSTRUMENTET DHE METODOLOGJIA E MONITORIMIT MBI PROCEDURËN E VLERËSIMIT DHE RENDITJES SË ANËTARËVE JO-GJYQTARË TË GJYKATËS SË LARTË	18
Kriteret për vlerësimin dhe renditjen e kandidatëve	18
Objekti i monitorimit për renditjen e kandidatëve	19
Metodologjia e mbledhjes së të dhënave për vlerësimin dhe renditjen e kandidatëve.....	20
RASTE PRAKTIKE	23
EKSTRAKTE NGA LEGJISLACIONI	27
BIBLIOGRAFIA	32

HYRJE

Në vitin 2016 Republika e Shqipërisë ndërmori një reformë të thellë të sistemit të drejtësisë. Në fokusin e kësaj reforme ishte, midis të tjerash, forcimi i meritokracisë në karrierat gjyqësore, e cila konsiderohet një parakusht për rritjen e profesionalizmit dhe integritetit të gjyqtarëve.

Në këtë kuadër zhvillimesh të vrullshme ligjore dhe institucionale, Instituti për Studime Publike & Ligjore (ISPL), me mbështetjen e Bashkimit Evropian në kuadrin e programit Shoqëria Civile dhe Media 2021 nën IPA III/2022/441-466, ka zhvilluar, ndër të tjera, një metodologji për matjen e meritokracisë në karrierat gjyqësore.

Manuali i Trajnimit mbi “Emërimin e anëtarëve jo-gjyqtarë të Gjykatës së Lartë” vjen si një vijimësi e Metodologjisë “Meritokracia në karrierat gjyqësore” (“**Metodologji/a**”), synimi i të cilës është aftësimi i aktorëve të shoqërisë civile për monitorimin e procedurave që kryhen nga KLGj për ngritjen në detyrë të gjyqtarëve, nëpërmjet:

- thjeshtëzimit dhe lehtësimit të procesit të monitorimit nga shoqëria civile të këtyre procedurave, duke synuar të identifikojë situata dhe siguruar rekomandime të përshtatshme në funksion të rritjes së meritokracisë në promovimin e gjyqtarëve dhe të përgjegjshmërisë së Këshillit të Lartë Gjyqësor në vlerësimin e performancës së gjyqtarëve;
- ofrimit të një kuadri të përgjithshëm monitorimi për aktorët e shoqërisë civile (*organizatat, mediat, studentët e drejtësisë, etj*), me një përmbajtje efektive, të thjeshtë dhe praktike, në mënyrë që të nxiten, të përmirësohen dhe të harmonizohen nismat e tyre të monitorimit të procedurave për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve.

Në vijim të treguesve dhe faktorëve të përcaktuara në Metodologji, nëpërmjet këtij Manuali do të analizohen në mënyrë të detajuar të gjitha elementet që duhet të zbatohen për zhvillimin e karrierës së anëtarëve jo-gjyqtarë të Gjykatës së Lartë, duke u ndalur në tri kategori kryesore:

1. kriteret ligjore për caktimin e anëtarëve jo-gjyqtarë të Gjykatës së Lartë dhe metodologjia e mbledhjes së të dhënave lidhur me kriteret ligjore;
2. procedurat e emërimit të anëtarëve jo-gjyqtarë të Gjykatës së Lartë dhe metodologjia e mbledhjes së të dhënave lidhur me procedurën e emërimit;
3. kriteret për vlerësimin dhe renditjen e kandidatëve dhe metodologjia e mbledhjes së të dhënave lidhur me këto kritere.

Manuali do të ndahet në tre module, ku secili modul do të strukturohet me qëllim analizimin në mënyrë të detajuar të të gjitha elementeve që përmbajnë tri kategoritë e mësipërme:

- A. **Moduli i parë** do të përmbajë një analizë të detajuar të kritereve ligjore për emërimin e anëtarëve jo-gjyqtarë të Gjykatës së Lartë, duke përfshirë por pa u kufizuar, listimin e kritereve ligjore (*përfshirë identifikimin e dispozivate përkatëse ligjore*), objektivat e monitorimit dhe metodologjinë e mbledhjes së të dhënave.
- B. **Moduli i dytë** do të përmbajë një analizë të detajuar të procedurës së emërimit të anëtarëve jo-gjyqtarë të Gjykatës së Lartë, duke përfshirë por pa u kufizuar, një prezantim të shkurtër mbi elemente të përgjithshme të procedurës së emërimit, objektivat e monitorimit së procedurës së emërimit dhe metodologjinë e mbledhjes së të dhënave mbi procedurën e emërimit.
- C. **Moduli i tretë** do të përmbajë një analizë të detajuar të vlerësimit dhe të renditjes së kandidatëve për anëtarë jo-gjyqtarë të Gjykatës së Lartë, duke përfshirë por pa u kufizuar, listimin e kritereve për vlerësimin dhe renditjen e kandidatëve (*përfshirë identifikimin e dispozivate përkatëse ligjore*), objektivat e monitorimit të renditjes së kandidatëve dhe metodologjinë e mbledhjes së të dhënave mbi procedurën e emërimit.

OBJEKTIVAT DHE REZULTATET QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Duke marrë në konsideratë që:

(i) synimi final i Metodologjisë “Meritokracia në karrierat gjyqësore” është realizimi i një presioni pozitiv mbi KLGj-në, me qëllim që ky i fundit të garantojë inkuadrimin e meritokracisë si një gjendje të qëndrueshme ku gjyqtarët caktohen sistematikisht në pozicionet e karrierës

dhe se

(ii) ky synim pritet të arrihet përmes monitorimit të jashtëm, të pavarur dhe profesional të karrierave gjyqësore nga shoqëria civile,

Ky Manual ka për qëllim aftësimin e aktorëve të shoqërisë civile, të studentëve, të gazetarëve, të praktikantëve të ligjit dhe thellimin e njohurive të tyre mbi parimet dhe standardet e zhvillimit të karrierës së gjyqtarëve, me fokus specifik zhvillimin e karrierës së anëtarëve jo-gjyqtarë të Gjykatës së Lartë.

Rrjedhimisht, Manuali synon të:

- ofrojë informacion dhe njohuri mbi kushtet e zgjedhshmërisë/emërimit të anëtarëve jo-gjyqtarë të Gjykatës së Lartë, instrumentet dhe metodologjinë e monitorimit të secilit kusht të zgjedhshmërisë dhe metodologjinë e mbledhjes së të dhënave të nevojshme;
- ofrojë informacion dhe njohuri mbi procedurën e emërimit të anëtarëve jo-gjyqtarë të Gjykatës së Lartë, instrumentet dhe metodologjinë e monitorimit të secilit hap të procedurës së emërimit dhe metodologjinë e mbledhjes së të dhënave të nevojshme;
- ofrojë informacion dhe njohuri mbi procedurën e vlerësimit dhe renditjes sipas meritës të anëtarëve jo-gjyqtarë të Gjykatës së Lartë, instrumentet dhe metodologjinë e monitorimit të secilit kriter të vlerësimit dhe të renditjes dhe metodologjinë e mbledhjes së të dhënave të nevojshme.

Në përfundim të këtij manuali aktorët e shoqërisë civile do të kenë njohuritë dhe mekanizmat e duhura për të siguruar:

- ❖ informacion, në kohë reale, lidhur me vakancat në pozicionet e anëtarëve jo-gjyqtarë të Gjykatës së Lartë;
- ❖ monitorim të pavarur të vlerësimeve të KLGj-së lidhur me pëmbushjen ose jo të kushteve ligjore nga kandidatët;
- ❖ monitorim të pavarur të procedurave të emërimit të ndjekura nga KLGj për plotësimin e vendeve vakante të anëtarëve jo-gjyqtarë të Gjykatës së Lartë;
- ❖ monitorim të pavarur të vlerësimeve të KLGj-së lidhur me shkallën e përbushjes së kushteve dhe të zbatimit të kriterëve në vlerësimin dhe renditjen e kandidatëve për anëtarë jo-gjyqtarë të Gjykatës së Lartë.

duke përmirësuar thelbësisht aftësinë e tyre për të ndërmarrë nisma në kuadër të llogaridhënies efektive, rritjes së përgjegjshmërisë nga ana e institucioneve të drejtësisë dhe përmirësimit të legjislacionit të sistemit të drejtësisë, për realizimin e meritokracisë së karrierës në gjyqësor, nëpërmjet analizës së thelluar të standardeve të performancës të parashikuara në ligj dhe duke pasqyruar treguesit e realizimit dhe mënyrat e matjes së tyre faktikisht.

Rezultatet e pritshme nga kryerja e monitorimeve në kuadër të Metodologjisë “*Meritokracia në karrierat gjyqësore*”, do të shërbenin:

- (a) për të kuptuar nëse vendimet e KLGj-së për zhvillimin e karrierës në gjyqësor bazohen thjesht dhe vetëm në meritat e kandidatëve (*siç përcaktohen ato nga ligji*) apo në faktorë të paligjshëm si nepotizmi, korrupsioni etj;
- (b) si një referencë për të gjithë politikëbërësit, politikanët, aktorët e shoqërisë civile dhe donatorët që duan të informohen nëse karriera gjyqësore në Shqipëri zhvillohet në bazë të meritokracisë ose të faktorëve të tjerë (*jo të ligjshëm*);
- (c) si i vetmi burim i të dhënave të qëndrueshme (*cilësore dhe sasimore*) dhe të përshtatura për vlerësimin e cilësisë së politikave dhe praktikës së ndjekur nga KLGj lidhur me karrierën e gjyqtarëve;
- (d) si lëndë e parë në procesin e përpilimit të politikave si dhe në vendimarrjen institucionale në fushën e vlerësimit të karrierës gjyqësore.

STRUKTURIMI DHE PËRMBAJTJA E MODULEVE

MODULI 1	<p>INSTRUMENTET DHE METODOLOGJIA E MONITORIMIT MBI KUSHTET E ZGJEDHSHMËRISË SË ANËTARËVE JO-GJYQTARË TË GJYKATËS SË LARTË</p> <p><i>Kriteret ligjore</i></p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Listimi i kriterëve ligjore për emërimin e anëtarëve jo-gjyqtarë të Gjykatës së Lartë (anëtarëve jo-gjyqtarë të Gjykatës së Lartë); ▪ Objektivat e monitorimit në lidhje me kriteret ligjore; ▪ Metodologjia e mbledhjes së të dhënave në lidhje me kriteret ligjore.
MODULI 2	<p>INSTRUMENTET DHE METODOLOGJIA E MONITORIMIT MBI PROCEDURËN E EMËRIMIT TË ANËTARËVE JO-GJYQTARË TË GJYKATËS SË LARTË</p> <p><i>Procedura e emërimit të anëtarëve jo-gjyqtarë të Gjykatës së Lartë</i></p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Prezantim mbi elementet e procedurës së emërimit; ▪ Objektivat e monitorimit në lidhje me procedurën e emërimit; ▪ Metodologjia e mbledhjes së të dhënave në lidhje me procedurën e emërimit.
MODULI 3	<p>INSTRUMENTET DHE METODOLOGJIA E MONITORIMIT MBI PROCEDURËN E VLERËSIMIT DHE RENDITJES SË ANËTARËVE JO-GJYQTARË TË GJYKATËS SË LARTË</p> <p><i>Procedura e vlerësimit dhe renditjes së anëtarëve jo-gjyqtarë të Gjykatës së Lartë</i></p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Listimi i kriterëve për vlerësimin dhe renditjen e kandidatëve (<i>përfshirë identifikimin e dispozitave përkatëse ligjore</i>); ▪ Objektivat e monitorimit mbi renditjen e kandidatëve; ▪ Metodologjia e mbledhjes së të dhënave në lidhje me renditjen e kandidatëve.
EKSTRAKTE NGA LEGJISLACIONI	
RASTE PRAKTIKE	

PLANI I TRAJNIMIT

Prezantimi i manualit sipas moduleve të strukturuar si më lart mund të realizohet në një kohëzgjatje prej 2 orësh, sipas tabelës së mëposhtme:

Aktiviteti	Metoda	Kohëzgjatja
<p>Instrumentet dhe metodologjia e monitorimit mbi kushtet e zgjedhshmërisë të anëtarëve jo-gjyqtarë të Gjykatës së Lartë (Moduli 1)</p> <p>Me anë këtij moduli pjesëmarrësit do të njihen me kriteret ligjore që duhet të plotësohen nga kandidatët për anëtarë jo-gjyqtarë të Gjykatës së Lartë, objektivat e monitorimit për çdo kriter dhe metodologjinë e mbledhjes së të dhënave.</p>	<p>Prezantim me powerpoint</p> <p>Realizimi i diskutimeve interactive/rasteve praktike (nëse është rasti)</p>	<p>1.5 orë</p>
<p>Instrumentet dhe metodologjia e monitorimit mbi procedurën e emërimit të anëtarëve jo-gjyqtarë të Gjykatës së Lartë (Moduli 2)</p> <p>Me anë këtij moduli pjesëmarrësit do të njihen me elementet e procedurës së emërimit për anëtarë jo-gjyqtarë të Gjykatës së Lartë, objektivat e monitorimit për çdo element të procedurës dhe metodologjinë e mbledhjes së të dhënave.</p>	<p>Prezantim me powerpoint</p> <p>Realizimi i diskutimeve interactive/rasteve praktike (nëse është rasti)</p>	<p>1.5 orë</p>
<p>Instrumentet dhe metodologjia e monitorimit mbi procedurën e emërimit të anëtarëve jo-gjyqtarë të Gjykatës së Lartë (Moduli 3)</p> <p>Me anë këtij moduli pjesëmarrësit do të njihen me elementet e vlerësimit dhe renditjes të kandidatëve për anëtarë jo-gjyqtarë të Gjykatës së Lartë, objektivat e monitorimit për renditjen dhe metodologjinë e mbledhjes së të dhënave.</p>	<p>Prezantim me powerpoint</p> <p>Realizimi i diskutimeve interactive/rasteve praktike (nëse është rasti)</p>	<p>1.5 orë</p>

MODULI 1

INSTRUMENTET DHE METODOLOGJIA E MONITORIMIT MBI KUSHTET E ZGJEDHSHMËRISË SË ANËTARËVE JO-GJYQTARË TË GJYKATËS SË LARTË

Për qëllim të këtij Manuali dhe në cilësinë e përkufizimit, emërimi i juristëve jo-gjyqtarë në Gjykatën e Lartë është “*caktimi i juristëve jo-gjyqtarë në pozicione në Gjykatën e Lartë*”.

Kriteret ligjore

Bazuar në parashikimet e ligjit 96/2016 “Për Statusin e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve” dhe në Kushtetutë, emërimi i juristëve jo-gjyqtarë në Gjykatën e Lartë është i mundur përkundrejt plotësimit të kriterëve ligjore të mëposhtme:

Juristi i spikatur (jo-gjyqtar) që:

- gëzon shtetësinë shqiptare;
- ka zotësi të plotë për të vepruar;
- nuk është dënuar me vendim penal të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale, që, për shkak të natyrës së veprës së kryer, diskretiton pozitën dhe figurën e gjyqtarit ose prokurorit ose dëmton rëndë besimin e publikut në sistemin gjyqësor, pavarësisht nëse është rehabilituar sipas parashikimeve të Kodit Penal;
- nuk është larguar nga detyra ose nuk i është hequr licenca, autorizimi ose leja për ushtrimin e një profesioni për shkaqe disiplinore, pavarësisht nëse masa disiplinore konsiderohet e shuar, si dhe nuk ka masë disiplinore në fuqi;
- nuk ka qenë anëtar, bashkëpunëtor ose i favorizuar nga Sigurimi i Shtetit përpara vitit 1990;
- nuk ka qenë bashkëpunëtor, informator ose agjent i shërbimeve sekrete;
- ka gradë shkencore në drejtësi;
- ka jo më pak se 15 vjet përvojë si avokat, profesor ose lektor i së drejtës, si jurist i nivelit të lartë në administratën publike ose në fusha të tjera të së drejtës;
- nuk ka mbajtur funksione politike në administratën publike ose pozicione drejtuese në parti politike gjatë 10 viteve të fundit para kandidimit;
- dhe që kalon me sukses verifikimin e plotë të figurës dhe pasurisë.

caktohet (*promovohet*) në një pozicion në Gjykatën e Lartë.

Objekti i monitorimit të kriterëve ligjore

Është pikërisht plotësimi i kriterëve ligjore ai që shërben për t'u monitoruar dhe kuptuar nëse, kandidatët jo gjyqtarë që konkurrojnë për pozicione në Gjykatën e Lartë, i plotësojnë apo jo kushtet e kërkuara nga ligji për të lejuar konkurrimin e tyre.

Pra, objekti i monitorimit të kriterëve ligjore do të jetë evidentimi i plotësimit ose jo të kriterëve ligjore dhe në format tabelar do të paraqitet si vijon:

Tabela 1

Shtetësi shqiptare	Zotësi për të vepruar	Të dhëna penale të pas-tra	Mungesë mase disiplinore	Mospërkatesi me Sigurimin e Shtetit përpara viteve '90	Mospërkatesi me Shërbimet Sekrete	Gradë shkencore në Drejtësi	15 vjet përvojë profesionale	Mosmbajtje funksionesh politike 10 vitet e fundit	Kalim me sukses i verifikimit të figurës dhe pasurisë
PO/JO	PO/JO	PO/JO	PO/JO	PO/JO	PO/JO	PO/JO	PO/JO	PO/JO	PO/JO

Metodologjia e mbledhjes së të dhënave/informacionit mbi respektimin e kriterëve ligjore

Realizimi i monitorimit të plotësimit ose jo të kriterëve ligjore dikton nevojën e përcaktimit të instrumenteve konkrete që do të duhet të përdoren nga monitoruesi për të kërkuar dhe marrë të dhënat dhe informacionin e nevojshëm, për të vlerësuar nëse kriteret e kërkuara nga ligji për juristët jo-gjyqtarë, që konkurrojnë për një pozicion në Gjykatën e Lartë, janë respektuar apo jo nga KLGj-ja.

Kërkimi i të dhënave dhe i informacioneve nga çdo person, garantohet nga Ligji 119/2014 "Për të drejtën e informimit", si vijon:

{....}

Për lehtësi reference dhe të të kuptuarit, instrumentet e mbledhjes së të dhënave për secilin kriter, po e paraqesim **në format tabelar** si vijon:

Shtetësi shqiptare	Zotësi për të vepruar	Të dhëna penale të pas-tra	Mungesë mase disiplinore	Mospërkatesi me Sigurimin e Shtetit përpara viteve '90	Mospërkatesi me Shërbimet Sekrete	Gradë shkencore në Drejtësi	15 vjet përvojë profesionale	Mosmbajtje funksionesh politike 10 vitet e fundit	Kalim me sukses i verifikimit të figurës dhe pasurisë
Kërkesë zyrtare për informacion drejtuar KLGj-së	Kërkesë zyrtare për informacion drejtuar KLGj-së	Kërkesë zyrtare për informacion drejtuar KLGj-së	Kërkesë zyrtare për informacion drejtuar institucionit ku ka punuar më parë kandidati	Kërkesë zyrtare për informacion drejtuar KLGj-së	Kërkesë zyrtare për informacion drejtuar KLGj-së	Kërkesë zyrtare për informacion drejtuar KLGj-së	Kërkesë zyrtare për informacion drejtuar KLGj-së	Kërkesë zyrtare për informacion drejtuar KLGj-së	Kërkesë zyrtare për informacion drejtuar KLGj-së dhe ILDKPKI-së

KUJDES: Monitoruesi duhet të sigurohet nëse kandidati i plotëson ose jo 10 (dhjetë) kriteret ligjore të lartpërmendura.

MODULI 2

INSTRUMENTET DHE METODOLOGJIA E MONITORIMIT MBI PROCEDURËN E EMËRIMIT TË ANËTARËVE JO-GJYQ TARË TË GJYKATËS SË LARTË

Procedura e emërimit

1/5 e pozicioneve vakante në Gjykatën e Lartë plotësohen nëpërmjet procedurës së emërimit të juristëve jo-gjyqtarë.

KL Gj-ja organizon procedurë për emërimin e juristëve jo-gjyqtarë në Gjykatën e Lartë jo më vonë se 3 muaj përpara përfundimit të mandatit të anëtarit në detyrë që do të zëvendësohet nga një jurist jo-gjyqtar¹.

Objekti i monitorimit për procedurën

Për plotësimin e vendeve vakante në Gjykatën e Lartë, përmes procedurës së emërimit të juristëve jo-gjyqtarë, ligji kërkon që nga KL Gj-ja të ndërmerren 7 (shtatë) hapa, të cilët në format tabelar dhe për lehtësi reference do të ilustrheshin si vijon: ²

Tabela 3

Shpallje e pozicioneve të lira, të paktën tre muaj para mbarimit të mandatit	Pozicionet e lira janë në Gjykatën e Lartë dhe plotësohen nga juristë jo-gjyqtarë	Shpallje e pozicioneve të lira bëhet në faqen zyrtare të KL Gj-së	Shpallje e pozicioneve të lira përmban informacionin e kërkuar nga ligji	Afati i përgatitjes për kandidatët është, të paktën, 2 javë nga data e shpalljes	KL Gj-ja kërkon raportim nga institucioni kompetent për verifikim të figurës dhe pasurisë brenda 1 jave nga parashtrimi i kandidaturës	Verifikimi i plotësimin të kushteve dhe propozim i kandidatëve brenda një afati të arsyeshëm ²
PO/JO	PO/JO	PO/JO	PO/JO	PO/JO	PO/JO	PO/JO

1. Kjo kërkesë zbatohet vetëm për analogji (dhe si praktikë e mirë pune) pasi ligji nuk e kërkon shprehimisht.
2. Ligji nuk parashikon shprehimisht një afat brenda të cilit KL Gj-ja duhet të kryejë verifikimin nëse kandidatët i plotësojnë kushtet ligjore për ngritje në detyrë. Sidoqoftë, duke pasur parasysh se procesi i verifikimit përfshin komunikimin shkresor me ILDKPKIKI-në për verifikimin e pasurisë së kandidatit, dhe me Byronë Kombëtare të Hetimit (ose Shërbimin Informativ Shtetëror) për verifikimin e figurës së kandidatit (shih nenet 48/7 dhe 32/2-7 të ligjit 96/2016 “Për statusin e gjyqtarit dhe prokurorit”), si dhe duke pasur parasysh se afati maksimal ligjor për plotësimin e pozicionit vakant është 3 muaj nga data e shpalljes së vakancës (shih nenin 48/2 të ligjit 96/2016 “Për statusin e gjyqtarit dhe prokurorit”), për qëllimet e këtij Manuali do të konsiderohet afat i arsyeshëm për verifikimin e kushteve të kandidimit 30 ditë nga data e dorëzimit të dosjes së kandidimit.

KUJDES: Monitoruesi sigurohet për kryerjen ose jo të këtyre 7 (shtatë) hapave proceduralë dhe verifikimeve përkatëse.

Metodologjia e mbledhjes së të dhënave për procedurën

Edhe në këtë rast, sukcesi dhe efikasiteti i monitorimit dikton nevojën e përcaktimit të instrumenteve përkatëse për të siguruar të dhënat dhe informacionin e nevojshëm, për të vlerësuar nëse KLGj-ja ka kryer procedurat dhe verifikimet e kërkuara nga ligji për emërimin e juristëve jo-gjyqtarë në pozicione në Gjykatën e Lartë.

Instrumentet e kërkimit të të dhënave dhe informacionit për çdo hap të procedurës që duhet të ndiqet nga KLGj-ja, në format tabelar do të parashtraheshin si vijon:

Tabela 4

Shpallje e pozicioneve të lira, të paktën <u>tre muaj</u> para mbarimit të mandatit	Pozicionet e lira janë në Gjykatën e Lartë dhe plotësohen nga juristë jo-gjyqtarë	Shpallje e pozicioneve të lira bëhet në faqen zyrtare të KLGj-së	Shpallje e pozicioneve të lira përmban informacionin e kërkuar nga ligji	Afati i përgatitjes për kandidatët është, të paktën, 2 javë nga data e shpalljes	KLGj-ja kërkon raportim nga institucioni kompetent për verifikim të figurës dhe të pasurisë brenda 1 jave nga kandidimi	Verifikimi i plotësisimit të kushteve dhe propozim i kandidatëve brenda një afati të arsyeshëm ³
<i>Konsultim periodik i faqes zyrtare të KLGj-së</i>	<i>Konsultim periodik i faqes zyrtare të KLGj-së</i>	<i>Konsultim periodik i faqes zyrtare të KLGj-së</i>	<i>Konsultim periodik i faqes zyrtare të KLGj-së</i>	<i>Konsultim periodik i faqes zyrtare të KLGj-së</i>	<i>Kërkesë zyrtare për informacion drejtuar KLGj-së</i>	<i>Konsultim periodik i faqes zyrtare të KLGj-së dhe kërkesë zyrtare për informacion drejtuar KLGj-së</i>

Me qëllim realizimin e një sigurie maksimale të respektimit korrekt dhe të plotë të procedurës së emërimit, monitoruesit mund të përdorin indikatorët e mëposhtëm për të matur përmbushjen e hapave të lartpërmendur të procedurës.

- Respektimi i afateve kohore të lidhura me procedurën, siç janë:
 - (i) Afati tremujor për shpalljen e pozicioneve të lira, para mbarimit të mandatit përkatës;
 - (ii) Afati dyjavor i përgatitjes së kandidatit nga data e shpalljes së pozicioneve të lira;

3. Ligji nuk parashikon shprehimisht një afat brenda të cilit KLGj-ja duhet të kryejë verifikimin nëse kandidatët i plotësojnë kushtet ligjore për ngritje në detyrë. Sidoqoftë, duke pasur parasysh se procesi i verifikimit përfshin komunikimin shkresor me ILDKPKIKI-në për verifikimin e pasurisë së kandidatit, dhe me Byronë Kombëtare të Hetimit (ose Shërbimin Informativ Shtetëror) për verifikimin e figurës së kandidatit (shih nenet 48/7 dhe 32/2-7 të ligjit të statusit), si dhe duke pasur parasysh se afati maksimal ligjor për plotësimin e pozicionit vakant është 3 muaj nga data e shpalljes së vakancës (shih nenin 48/2 të ligjit të statusit), për qëllimet e kësaj Metodologjie do të konsiderohet afati i arsyeshëm për verifikimin e kushteve të kandidimit 30 ditë nga data e dorëzimit të dosjes së kandidimit.

- (iii) Afati njëjavor i kërkesës së KLGj-së për raportim nga institucionet kompetente, për verifikim të figurës dhe pasurisë, nga data e kandidimit;
 - (iv) Afati tridhjetëditor si një afat i arsyeshëm nga data e dorëzimit të dosjes së kandidatit, për verifikim të plotësisimit të kushteve dhe propozimit të kandidatëve;
- Respektimi i raportit ligjor midis kandidaturave që vijnë nga gjyqësori dhe atyre që vijnë nga radhët e juristëve;
 - Modalitetet e shpalljes së pozicioneve të lira.

Përdorimi i indikatorëve të lartpërmendur do të kushtëzohej nga instrumente të kërkimit të të dhënave dhe informacionit, që në format tabelar do të paraqitej si vijon:

Tabela 5

Respektimi i afateve kohore të lidhura me procedurën	Respektimi i raportit ligjor midis kandidaturave që vijnë nga gjyqësori dhe atyre që vijnë nga radhët e juristëve	Modalitetet e shpalljes së pozicioneve të lira
1. <i>Konsultim periodik i faqes zyrtare të KLGj-së</i> 2. <i>Kërkesë zyrtare për informacion drejtuar KLGj-së;</i> 3. <i>Intervista të mundshme me kandidatët</i>	1. <i>Konsultim periodik i faqes zyrtare të KLGj-së;</i> 2. <i>Kërkesë zyrtare për informacion drejtuar KLGj-së (ku ndër të tjera mund të kërkohet informacion mbi numrin e kandidatëve për çdo pozicion të lirë, historiku i tyre profesional, etj);</i>	<i>Konsultim periodik i faqes zyrtare të KLGj-së</i>

MODULI 3

INSTRUMENTET DHE METODOLOGJIA E MONITORIMIT MBI PROCEDURËN E VLERËSIMIT DHE RENDITJES SË ANËTARËVE JO-GJYQTARË TË GJYKATËS SË LARTË

Kriteret për vlerësimin dhe renditjen e kandidatëve

Vlerësimi, pikëzimi dhe renditja e kandidatëve për çdo pozicion të lirë në Gjykatën e Lartë, ka për qëllim identifikimin e kandidatit që përfaqëson juristin më të spikatur në kuptim të nenit 136, pika 3, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenit 49, pika 1, të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Identifikimi i kandidatit që përfaqëson juristin më të spikatur, bazohet në këto kategori kriteresh:

- meritat profesionale;
- meritat morale dhe etike;
- meritat organizative dhe menaxheriale.

Referuar në nenin 49/6 të Ligjit 96/2016 “Për Statusin e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve”, Vendimin nr. 102, datë 05.07.2019 “Mbi kriteret e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve jogjyqtarë dhe procedurën e përzgjedhjes për emërim në Gjykatën e Lartë” si dhe Vendimin nr. 209, datë 11.10.2019 “Për miratimin e metodologjisë për vlerësimin dhe pikëzimin e kandidatëve jogjyqtarë për në Gjykatën e Lartë”, KLGj-ja ka përcaktuar treguesit e kategorive të lartpërmendura të kriterëve dhe mënyrën e pikëzimit të tyre për vlerësimin e kandidatëve.

Më konkretisht, pasi përfundon verifikimin e kushteve të zgjedhshmërisë nga ana e kandidatëve (*shih Tabelën 1*) dhe shpall listën e kandidatëve që lejohen të konkurrojnë për në Gjykatën e Lartë, KLGj-ja vlerëson, pikëzon dhe rendit kandidaturat sipas meritës, duke u bazuar në treguesit e mëposhtëm:

- ❖ ekspertizë e veçantë e kandidatit në fusha të veçanta të ligjit, sipas kërkesave të shpallura për pozicionin e lirë;
- ❖ vlerësim i punës së kandidatit, përmes të paktën 5 (pesë) dokumenteve ligjore, të hartuara gjatë përvojës së tij në profesion në 5 (pesë) vitet e fundit, si dhe çdo

publikim shkencor dhe artikull akademik në fushën e ligjit sipas rëndësisë së punimit, nëpërmjet të cilave tregohen të dhëna edhe për pjesëmarrjen e kandidatit në aktivitetet shkencore, në procese të hartimit ose të konsultimit të legjislacionit, apo në çdo angazhim tjetër profesional;

- ❖ rezultate të studimeve të larta për drejtësi, të programit të formimit fillestar, përvojës në profesion, ose çdo trajnimi tjetër;
- ❖ cilësitë morale të kandidatit, të tilla si ndershmëria, përpikmëria në ushtrimin e detyrave, drejtësia në marrjen e vendimeve, përgjegjshmëria, besueshmëria, paanësia, dinjiteti dhe prirja për të marrë përsipër përgjegjësi;
- ❖ cilësia e platformës dhe vizionit të kandidatit, për aftësitë e tij për të marrë vendime dhe përgjegjësi referuar përvojave të mëparshme profesionale, për aftësitë e komunikimit, për aftësitë e të punuarit në grup dhe në ambiente multidisiplinore ose multikulturore;
- ❖ aftësitë gjuhësore të kandidatit, të treguara nëpërmjet certifikatave dhe gjatë intervistimit.

Objekti i monitorimit për renditjen e kandidatëve

Respektimi dhe plotësimi i kriterëve të kërkuara nga ligji për vlerësimin dhe renditjen e kandidatëve jo-gjyqtarë që konkurrojnë për pozicione në Gjykatën e Lartë, nga KLGj-ja, përfaqëson objektin e monitorimit.

KLgj-ja vlerëson, pikëzon dhe rendit kandidaturat në bazë të kriterëve të treguara në tabelën e mëposhtme:

Tabela 6

<i>Ekspertiza e veçantë e kandidatit në fushën e së drejtës që përkon me pozicionin</i>	<i>Vlerësimi i punimeve, studimeve të kandidatit gjatë 5 viteve të fundit</i>	<i>Rezultatet e kandidatit gjatë studimeve</i>	<i>Aftësitë në zotërimin e gjuhëve të huaja</i>	<i>Cilësitë morale të kandidatit</i>	<i>Cilësitë e platformës dhe vizionit</i>
{pikët}	{pikët}	{pikët}	{pikët}	{pikët}	{pikët}

Në përfundim të vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidaturave sipas kriterëve të treguara në Tabelën nr. 5, KLGj-ja i propozon Presidentit të Republikës emërimin e kandidatit që ka marrë numrin më të madh të pikëve.

KUJDES: Monitoruesi duhet të sigurohet për respektimin e këtyre 6 (gjashtë) kriterëve të treguara në tabelën nr. 5, si dhe për saktësinë e pikëzimit të kandidatëve nga KLGj-ja.

Metodologjia e mbledhjes së të dhënave për vlerësimin dhe renditjen e kandidatëve

Si në të gjitha proceset e monitorimit të përmendura në këtë manual dhe jo vetëm, edhe monitorimi i zbatimit/plotësimit të kriterëve të klasifikuara në Tabelën 6 ka nevojë për instrumentet e veta të marrjes së të dhënave dhe informacionit.

Rrjedhimisht kriteret dhe instrumentet përkatëse të marrjes së të dhënave dhe informacionit do të listoheshin si vijon, në format tabelar:

Tabela 7

<i>Ekspertiza e veçantë e kandida- tit në fushën e së drejtës që përkon me pozicionin</i>	<i>Vlerësimi i puni- meve, studimeve të kandidatit gjatë 5 viteve të fundit</i>	<i>Rezultatet e kandidatit gjatë studimeve</i>	<i>Aftësitë në zotërimin e gjuhëve të huaja</i>	<i>Cilësitë morale të kandidatit</i>	<i>Cilësitë e platformës dhe vizionit</i>
1. Konsultim periodik i faqes zyrtare të KLGj-së 2. Kërkesë zyrtare për informacion drejtuar KLGj-së; 3. Intervista të mundshme me kandidatët	1. Konsultim periodik i faqes zyrtare të KLGj-së 2. Kërkesë zyrtare për informacion drejtuar KLGj-së; 3. Intervista të mundshme me kandidatët	1. Konsultim periodik i faqes zyrtare të KLGj-së 2. Kërkesë zyrtare për informacion drejtuar KLGj-së; 3. Intervista të mundshme me kandidatët	1. Konsultim periodik i faqes zyrtare të KLGj-së 2. Kërkesë zyrtare për informacion drejtuar KLGj-së; 3. Intervista të mundshme me kandidatët	1. Konsultim periodik i faqes zyrtare të KLGj-së 2. Kërkesë zyrtare për informacion drejtuar KLGj-së; 3. Intervista të mundshme me kandidatët	1. Konsultim periodik i faqes zyrtare të KLGj-së 2. Kërkesë zyrtare për informacion drejtuar KLGj-së; 3. Intervista të mundshme me kandidatët

Matja e nivelit të plotësimit të kriterëve të lartpërmendura do të mund të realizohej nëpërmjet indikatorëve të mëposhtëm.

- Niveli i ekspertizës në fushën përkatëse të specializimit do të përcaktohej nga:
 - kohëzgjatja e angazhimit të kandidatit në fushën specifike përkatëse;
 - botimet përkatëse dhe ndikimi i rezultateve profesionale në zhvillimin e doktrinës dhe jurisprudencës në fushën e specializimit;
 - konsulenca contribute në hartimin e legjislacionit, por jo vetëm, në fushën përkatëse të specializimit;
 - pjesëmarrja në konferenca shkencore;
 - mësimdhënia në fushën përkatëse të specializimit;
 - gradat dhe titujt shkencorë në fushën përkatëse të specializimit.

- Niveli i vlerësimit të punimeve të kandidatit gjatë 5 viteve të fundit do të përcaktohej nga:
 - originaliteti dhe impakti;
 - aftësitë analitike dhe hulumtuese;
 - saktësia, zhvillimi logjik, lexueshmëria, kuptueshmëria dhe gjithëpërfshirja;
 - interpretimi i harmonizuar;
 - referencat e praktikës gjyqësore.

- Niveli i rezultatit të studimeve të kandidatit do të përcaktohej nga:
 - kalimi ose jo i nivelit minimal të pranueshëm të rezultateve të studimeve, të përcaktuar nga KLGj-ja (*nota 8*);
 - rezultatet e formimit fillestar të kandidatit (*Shkolla e Magjistraturës, Shkolla e Administratës Publike, Shkolla e Avokatisë*);
 - rezultatet e trajnimeve të tjera, kualifikimeve pasuniversitare dhe gradat/titujt shkencorë.

- Niveli i aftësisë së zotërimit të gjuhëve të huaja do të përcaktohej nga:
 - njohuritë në gjuhët anglisht, frëngjisht, gjermanisht, italisht dhe spanjisht, sipas nenit 49, pika 3 dhe pika 6, shkronja “ç”, të Ligjit nr. 96/2016. Përparësi të veçantë marrin njohuritë në gjuhët angleze dhe franceze.
 - vlerësimi i ekspertit të gjuhës së huaj, në ato raste kur ai është angazhuar nga KLGj-ja.

- Niveli i cilësive morale të kandidatit do të përcaktohej nga:
 - shmangia e shfaqjes së pahijshme;
 - nderi dhe dinjiteti;
 - reagimi i kandidatit kundrejt pritshmërive të publikut, duke demonstruar cilësitë personale të mençurisë, ndershmërisë, ndjenjës së humanizmit, guximit, seriozitetit dhe maturisë.
 - vetëdijësimi i kandidatit se sjellja profesionale, jeta private dhe sjellja në shoqëri kanë ndikim në imazhin e drejtësisë dhe besimit të publikut.

- Niveli i cilësisë së platformës dhe vizionit do të përcaktohej nga:
 - vlera dhe origjinaliteti i arsytimit dhe objektivave të prezantuar nga kandidati në dokumentin ku paraqet programin dhe vizionin e tij mbi qasjen për të realizuar një organizim dhe funksionim cilësor dhe efikas të Gjykatës së Lartë, në ushtrimin e funksioneve të parashikuara në Kushtetutë dhe ligj;

- niveli i kuptimit që kandidati ka për rolin e tij si gjyqtar në Gjykatën e Lartë dhe për rolin e Gjykatës së Lartë si e tillë;
- vizioni i kandidatit në lidhje me sfidat kryesore me të cilat përballlet Gjykata e Lartë nga perspektiva organizative dhe e çështjeve thelbësore të së drejtës;
- mendimet dhe sugjerimet e kandidatit për t'i adresuar këto sfida.
- aftësitë vendimmarrëse të kandidatit;
- aftësitë e komunikimit të kandidatit;
- aftësitë për të punuar në skuadër dhe ambiente multidisiplinore;

RASTE PRAKTIKE

Rasti A:

“...” paraqet kandidaturën për pozicionin e anëtarit jogjyqtar në Gjykatën e Lartë. Përvoja e saj profesionale ishte si vijon:

- ❖ Juriste” në KESH sh.a e Divizionit Shkodër, për periudhën 15.03.2004 - 05.12.2008;
- ❖ “Pedagoge” në Universitetin Jopublik “Kristal”, për periudhën 01.11.2009 - 30.09.2013;
- ❖ “Përgjegjëse departamenti” në Universitetin Jopublik “Kristal”, për periudhën 01.10.2013 - 15.09.2014;
- ❖ “Specialiste” në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave për periudhën 06.01.2016 -01.02.2018;
- ❖ “Këshilltare Ligjore” në Institucionin e Komisionerëve Publikë, për periudhën 01.02.2018 pa datë mbyllje.

Pyetje:

Bazuar në sa më lart, a e plotëson kandidatja kriterin e përvojës profesionale prej jo më pak se 15 vjetësh si avokat, profesor ose lektor i së drejtës, jurist i nivelit të lartë në administratën publike, ose në fusha të tjera të së drejtës?

A përbën punësimi në KESH në pozicionin e juristes dhe punësimin në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave në pozicionin e specialistes “jurist të nivelit të lartë në administratën publike”? Nëse po, në çfarë kategorie do të përfshihej pozicioni i këshilltarit ligjor pranë Komisionerëve Publikë?

KL Gj-ja e skualifikon kandidaten për mospërbushje të kushtit ligjor të kandidimit të përcaktuar në nenin 136, pika 3, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në nenin 49, pika 1, të Ligjit “Për Statusin e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve” të përvojës profesionale prej jo më pak se 15 vjet, si avokat, profesor ose lektor i së drejtës, jurist i nivelit të lartë në

administratën publike ose në fusha të tjera të së drejtës, me arsyetimin se ekperiencia e saj profesionale e konfirmuar dhe e bazuar në kriterin e lartpërmendur është në total 14 vjet e 2 muaj e shtatë ditë, pra më pak se minimumi i kërkuar, 15 vjet.

Pyetje:

A është i bazuar në ligj ky vendim? Komente nga pjesëmarrësit!

Rasti B:

{...} paraqet kandidaturën për pozicionin e anëtarit jogjyqtar në Gjykatën e Lartë.

Nga verifikimi që KLGj-ja i bën dokumentacionit të siguruar nga kandidati dhe institucionet e tjera përkatëse, përfshirë ish-punëdhënësit e kandidatit, rezulton që për një pozicion punësimi, për kandidatin ishte marrë masa disiplinore e largimit nga puna për pjesëmarrje të paautorizuar nga institucioni punëdhënës në një takim me palë të treta.

Nga shpjegimet e siguruara nga kandidati, rezulton që sipas këtij të fundit, ajo çfarë kishte ndodhur nuk përbënte shkelje disiplinore sipas legjislacionit të kohës, dhe si rrjedhim nuk mund të pasohej me një masë disiplinore.

Pyetjes së KLGj-së nëse masa ishte kundërshtuar në Gjykatë, kandidati iu përgjigj se meqenëse ishte në fillimet e karrierës, nuk kishte dashur të fillonte një proces gjyqësor që do ta rëndonte më shumë marrëdhënien me institucionin, aq më tepër që pozicioni pasardhës i punës ishte në një institucion varësie të punëdhënësit në fjalë.

KLgj-ja arsyeston se nuk përfshihet në vendimmarrjen e saj të gjykojë procedurën dhe themelin e masës disiplinore të kandidatit, dhe, duke qenë se masa disiplinore është ende në fuqi, pasi nuk është kundërshtuar në Gjykatë, KLGJ-ja arrin në përfundimin që kandidati duhet të skualifikohet pasi bie ndesh me kriteret ligjore të zgjedhshmërisë së anëtarit jogjyqtar në Gjykatën e Lartë.

Pyetje:

A është i bazuar në ligj vendimi i KLGj-së për skualifikimin e kandidatit? Komente nga pjesëmarrësit!

Rasti C:

{...} paraqet kandidaturën për pozicionin e anëtarit jogjyqtar në Gjykatën e Lartë.

Nga verifikimi që KLGj-ja i bën dokumentacionit të siguruar nga kandidati dhe institucionet e tjera përkatëse, rezulton që kandidati ka qenë më parë anëtar i Gjykatës së Lartë në periudhën kohore 1998-2008. Më pas është angazhuar me veprimtari të tjera juridike në sektorin privat.

KL Gj-ja konstaton se kjo kandidaturë bie ndesh me parashikimet e nenit 136 të Kushtetutës, ku në mënyrë të shprehur është sanksionuar ndalimi i riemërimit të anëtarit të Gjykatës së Lartë, dhe i kërkon kandidatit të shprehet mbi këtë konstatim.

Sipas kandidatit, rasti konkret nuk përbën “**riemërim**”, por “**emërim**”, pasi ai po kandidon si jogjyqtar dhe jo si gjyqtar i Gjykatës së Lartë.

Në këndvështrimin e kandidatit, riemërimi ka lidhje me vazhdimësinë e mandatit, ndaj dhe quhet “riemërim”. Ndalea kushtetuese iu referohet kandidatëve gjyqtarë në detyrë në Gjykatën e Lartë. Për më tepër, sipas kandidatit, ligjvënësi nëse realisht do të kishte pasur si qëllim ndalimin e kandidimit për herë të dytë, do të ishte shprehur “**ndalohet kandidimi për herë të dytë**”.

Gjithashtu ai citoi edhe disa raste të tjera të emërimit për herë të dytë të disa anëtarëve të Gjykatës së Lartë, para reformës në drejtësi.

KL Gj-ja, pasi vlerësoi sa më lart, arrin në përfundimet e mëposhtme:

- Parashikimet kushtetuese (*Neni 136*) para dhe pas Reformës në drejtësi kanë sanksionuar se **gjytari i Gjykatës së Lartë nuk ka të drejtë të emërohet**.
- Gjithashtu, ligjvënësi, në rastin e gjyqtarit të Gjykatës së Lartë, ka zgjedhur të ndalojë qartësisht dhe pa ekuivok **riemërimin** e tij.
- Nga ana tjetër, ligjvënësi, kur ka çmuar, por në mënyrë të shprehur ka parashikuar mundësinë e rizgjedhjes/riemërimit **jo të menjëhershme** të një funksionari të lartë publik. Kështu një rast i tillë është parashikimi i bërë në nenin 147 pika 10, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ku thuhet se: “*Anëtarët e Këshillit të Lartë Gjyqësor e ushtrojnë detyrën me një kohë të plotë për një periudhë prej pesë vjetësh, pa të drejtë rizgjedhjeje të njëpasnjëshme.*”
- Nisur nga sa më lart, mund të thuhet se nëse ligjvënësi ka pasur vullnetin për të lejuar riemërimin jo të menjëhershëm të gjyqtarit të Gjykatës së Lartë, atëherë ai, sikurse ka parashikuar për funksionarë të tjerë publikë, këtë vullnet do ta kishte materializuar në një mënyrë të ndryshme. Përderisa nuk e ka bërë, Këshilli i Lartë Gjyqësor çmon se vullneti i ligjvënësit ka qenë pikërisht ai i ndalimit të riemërimit përgjithnjë të gjyqtarit të Gjykatës së Lartë, vullnet të cilin Këshilli ka detyrimin ta respektojë.

- Në vijim, nuk qëndron dhe nuk mund të pranohet as pretendimi i kandidatit, në lidhje me disa riemërime të bëra nga Presidenti i Republikës dhe Kuvendi i Shqipërisë. Pavarësisht nga sa kandidati pretendon, si dhe pavarësisht interpretimeve që mund të jenë bërë nga këto organe në raste të veçanta, Këshilli i Lartë Gjyqësor çmon se është në përgjegjësinë e tij kushtetuese dhe ligjore të vlerësojë dhe të vendosë për rastin e z. {...}.
- Po ashtu, Këshilli vlerëson se kandidati ka dështuar të provojë për qënien para të njëjtave rrethana të faktit dhe ligjit të zbatueshëm me rastet që ai referon.
- Si konkluzion KLGj-ja vendos të skualifikojë kandidatin {...}.

Pyetje:

A është i bazuar në ligj vendimi i KLGj-së për skualifikimin e kandidatit? Komente nga pjesëmarrësit!

EKSTRAKTE NGA LEGJISLACIONI

Ekstrakt nga ligji 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve”

“{.....}

Neni 28

Kriteret e pranimit në formimin fillestar

Çdo person ka të drejtë të kandidojë në Shkollën e Magjistraturës, për t’u pranuar në formimin fillestar për magjistrat, nëse përmbush njëkohësisht kriteret e mëposhtme:

a) ka zotësi të plotë për të vepruar;

b) **është** shtetas shqiptar;

e) ka përfunduar me pikët minimale të përcaktuara nga Shkolla e Magjistraturës studimet e integruara në drejtësi ose në një program të ciklit të dytë të studimeve universitare në drejtësi, të barasvlershëm me to, ose ka kryer me pikët minimale të përcaktuara nga Shkolla e Magjistraturës studimet universitare në drejtësi jashtë Shqipërisë dhe ka marrë një diplomë të barasvlershme, e njësuar sipas rregullave për njësimin e diplomave të parashikuar me ligj⁴;

ç) ka të paktën tre vjet përvojë profesionale aktive me kohë të plotë, pas përfundimit të studimeve të integruara në drejtësi sipas shkronjës “c” të këtij neni, në sistemin gjyqësor ose të prokurorisë, në administratën publike, profesionet e lira ligjore, mësimdhënie në fakultetet e drejtësisë, ose në **çdo** pozicion tjetër të barasvlershëm me to, në sektorin privat ose organizatat ndërkombëtare⁵;

d) nuk **është** dënuar me vendim penal të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale, që, për shkak të natyrës së veprës së kryer, diskrediton pozitën dhe figurën e gjyqtarit ose prokurorit ose dëmton rëndë besimin e publikut në sistemin gjyqësor, pavarësisht nëse **është** rehabilituar sipas parashikimeve të Kodit Penal;

4. Nuk është e zbatueshme në rastin e emërimit të anëtarëve jo-gjyqtarë në Gjykatën e Lartë - (neni 49 i Ligji 96/2016 “Për statusin e gjyqtarit dhe prokurorit”)

5. Nuk është e zbatueshme në rastin e emërimit të anëtarëve jo-gjyqtarë në Gjykatën e Lartë - (neni 49 i Ligji 96/2016 “Për statusin e gjyqtarit dhe prokurorit”)

dh) nuk **është** larguar nga detyra ose nuk i **është** hequr licenca, autorizimi ose leja për ushtrimin e një profesioni për shkaqe disiplinore, pavarësisht nëse masa disiplinore konsiderohet e shuar, si dhe nuk ka masë disiplinore në fuqi;

e) nuk **është** anëtar i partive politike në kohën e kandidimit⁶;

ë) nuk ka qenë anëtar, bashkëpunëtor ose i favorizuar nga Sigurimi i Shtetit përpara vitit 1990;

f) nuk ka qenë bashkëpunëtor, informator, ose agjent i shërbimeve sekrete.

{...}”

Ekstrakt nga ligji 119/2014 “Për të drejtën e informimit”

“{.....}

Neni 3

E drejta e informimit

1. **Çdo** person gëzon të drejtën e njohjes me informacionin publik, pa u detyruar të shpjegojë motivet.

2. Autoriteti publik **është** i detyruar të informojë kërkuesin nëse ka ose jo në zotërim informacionin e kërkuar.

3. **Çdo** person ka të drejtë të njihet me informacionin publik, nëpërmjet dokumentit origjinal ose duke marrë një kopje të tij në formën ose formatin që mundëson akses të plotë në përmbajtjen e dokumentit.

4. Informacioni publik që i **është** dhënë një personi, nuk mund t’i refuzohet asnjë personi tjetër që e kërkon atë, me përjashtim të rastit kur informacioni përmban të dhëna personale të subjektit, në përputhje me nenin 17 të këtij ligji.

{...}”

6. Nuk është e zbatueshme në rastin e emërimit të anëtarëve jo-gjyqtarë në Gjykatën e Lartë - (neni 49 i Ligji 96/2016 “Për statusin e gjyqtarit dhe prokurorit”)

Ekstrakt nga ligji 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve”

“{.....}

Neni 48

Ngritja në detyrë në shkallët më të larta ose të specializuara.

1. Pozicionet në Gjykatën e Lartë, Prokurorinë e Përgjithshme, Prokurorinë e Posaçme dhe gjykatat e posaçme për gjykimin e veprave penale të korrupsionit dhe krimit të organizuar plotësohen nëpërmjet procedurës së ngritjes në detyrë. Pozicionet në gjykatat e tjera të apelit plotësohen nëpërmjet procedurave të lëvizjes paralele, në përputhje me nenet 42 dhe 43 të këtij ligji.

2. Në rastin kur ka shumë pozicione të lira, të cilat nuk plotësohen me lëvizje paralele, secili Këshill organizon një procedurë ngritje në detyrë për **çdo** pozicion të lirë, të paktën një herë në **çdo** tre muaj. Pozicionet plotësohen jo më vonë se tre muaj nga dita e shpalljes së procedurës.

3. Këshillat shpallin procedurën e ngritjes në detyrë dhe bëjnë thirrje që të kandidojë: a) magjistrati që plotëson kriteret për ngritjen në detyrë, në përputhje me kërkesat e pozicionit të lirë të shpallur; b) magjistrati i komanduar ose magjistrati në skemën e delegimit që plotëson kriteret për ngritjen në detyrë, në përputhje me kërkesat e pozicionit të lirë të shpallur; c) juristi i spikatur, sipas përcaktimeve të nenit 49 të këtij ligji.

4. Kandidati që ka ushtruar funksionin si anëtar i Këshillit, përjashtohet nga procedura e ngritjes në detyrë gjatë kohës së ushtrimit të funksionit si anëtar, si dhe tre vjet pas mbarimit të mandatit.

5. Në zbatim të pikës 3, të këtij neni, shpallja publikohet të paktën në faqen zyrtare të Këshillit dhe duhet të përmbajë informacionin e nevojshëm për pozicionin e lirë, si dhe të përcaktojë: a) afatin e kandidimit, i cili **është** të paktën dy javë nga data e shpalljes së procedurës; b) informacionin dhe dokumentacionin që i bashkëlidhet kandidimit; c) procedurën e kandidimit dhe vendin e dorëzimit të dokumentacioni.

Ekstrakt nga Kushtetuta

“{.....}

Neni 136)

1. Gjyqtarët e Gjykatës së Lartë emërohen nga Presidenti i Republikës, me propozim të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për një mandat 9-vjeçar, pa të drejtë riemërimi.

2. Presidenti i Republikës, brenda 10 ditëve nga data e marrjes së vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, emëron gjyqtarin e Gjykatës së Lartë, me përjashtim të rasteve kur Presidenti konstaton se kandidati nuk plotëson kriteret e kualifikimit ose kushtet e zgjedhshmërisë,

sipas ligjit. Dekreti i Presidentit të Republikës për mosemërimin e kandidatit humbet fuqinë kur kundër tij votojnë shumica e anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Në këtë rast, si dhe kur Presidenti nuk shprehet, kandidati shpallet i emëruar dhe fillon detyrën brenda 15 ditëve nga data e vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

3. Gjyqtari i Gjykatës së Lartë zgjidhet nga radhët e gjyqtarëve me të paktën 13 vjet përvojë në ushtrimin e profesionit. Një e pesta e gjyqtarëve në këtë gjykatë përzgjidhet mes juristëve të spikatur me jo më pak se 15 vjet përvojë si avokatë, profesorë ose lektorë të së drejtës, juristë të nivelit të lartë në administratën publike ose në fusha të tjera të së drejtës. Kandidatët që përzgjidhen nga radhët e juristëve duhet të kenë gradë shkencore në drejtësi.

4. Kandidati jo-gjyqtar nuk duhet të ketë mbajtur funksione politike në administratën publike, ose pozicione drejtuese në parti politike, gjatë 10 vjetëve të fundit para kandidimit. Kritere të tjera dhe procedura e përzgjedhjes së gjyqtarit parashikohen me ligj.

Ekstrakt nga ligji 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve”

“{.....}

Neni 49

Emërimi i kandidatëve jogjyqtarë në Gjykatën e Lartë

1. Një e pesta e gjyqtarëve në Gjykatën e Lartë mund të përzgjidhen mes juristëve të spikatur, që kanë gradë shkencore në drejtësi, me jo më pak se 15 vjet përvojë si avokatë, profesorë ose lektorë të së drejtës, juristë të nivelit të lartë në administratën publike ose në fusha të tjera të së drejtës.

2. Kandidatët jogjyqtarë për pozicione në Gjykatën e Lartë duhet: a) të plotësojnë kriteret e përcaktuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “ë” dhe “f”, të nenit 28, të këtij ligji; b) të mos kenë mbajtur funksione politike në administratën publike, ose në pozicione drejtuese në parti politike, gjatë dhjetë viteve të fundit para kandidimit.

3. Kandidati që ka njohuri të një gjuhe të një shteti anëtar të Bashkimit Europian ka përparësi në vlerësim.

4. Këshilli i Lartë Gjyqësor publikon thirrjen për paraqitjen e kandidaturave, në përputhje me përcaktimet e bëra në pikat 3 dhe 5, të nenit 48, të këtij ligji.

5. Këshilli vlerëson përmbushjen e kriterëve, sipas parashikimeve të pikës 2, të këtij neni, dhe verifikon kandidatët, sipas parashikimeve të pikave 2 deri në 7, të nenit 32, të këtij ligji. Kandidatët, të cilët nuk përmbushin kriteret ose nuk kalojnë procesin e verifikimit të pasurisë dhe të figurës, përjashtohen nga kandidimi.

6. Këshilli i Lartë Gjyqësor vlerëson aftësitë profesionale të kandidatëve që plotësojnë kriteret ligjore, duke u bazuar në këta tregues: a) ekspertizën e veçantë të kandidatit në fusha të veçanta të ligjit, sipas kërkesave të shpallura për pozicionin e lirë; b) vlerësimin e punës së kandidatit, përmes të paktën pesë dokumenteve ligjore, të hartuara nga kandidati gjatë përvojës së tij në profesion gjatë pesë viteve të fundit, si dhe çdo publikim shkencor dhe artikull akademik në fushën e ligjit; c) rezultatet e studimeve të larta për drejtësi, të programit të formimit fillestar, përvojës në profesion ose çdo trajnimi tjetër; ç) aftësitë gjuhësore, të treguara nëpërmjet certifikatave dhe gjatë intervistimit.

7. Bazuar në vlerësimin e aftësive profesionale, Këshilli përgatit një listë vetëm me kandidatët e renditur me vlerësimin më mirë mes të gjithë kandidatëve, të cilët merren në pyetje në një seancë dëgjimore, për të marrë informacion lidhur me kriteret e parashikuara në pikën 8 të këtij neni.

8. Këshillat i renditin kandidatët sipas vlerësimit të aftësive profesionale dhe intervistës, duke iu referuar: a) së pari rezultateve të vlerësimit të aftësive profesionale, sipas parashikimeve të pikës 6 të këtij neni; b) së dyti, në rastet e rezultateve të njëjta të vlerësimit të aftësive profesionale, viteve të eksperiencës profesionale të përshtatshme për pozicionin e lirë.

9. Këshilli i Lartë Gjyqësor propozon me shkrim emërimin e kandidatëve. Propozimi duhet të jetë i arsyetuar në lidhje me përmbushjen e kriterëve ligjore prej tyre, si dhe duhet të pasqyrojë renditjen e kandidatëve, sipas kriterëve të parashikuara në pikën 8 të këtij neni.

10. Vendimi i propozimit për emërim është i ankimueshëm. Rregullat e parashikuara në nenin 41, pikat 2 deri në 4, aplikohen për aq sa gjejnë zbatim. Këshilli bën publik vendimin përfundimtar të propozimit për emërim në faqen e tij zyrtare.

11. Gjyqtari me renditjen më të lartë emërohet nga Presidenti i Republikës, në përputhje me nenin 136, pika 2, të Kushtetutës.

BIBLIOGRAFIA

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë

Ligji nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”

Ligji nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarit dhe prokurorit në Republikën e Shqipërisë”

Ligji 119/2014 “Për të drejtën e informimit”

Ligji 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”

Vendim i Këshillit të Lartë Gjyqësor, nr. 102 dt. 05.07.2019 “Mbi kriteret e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve jogjyqtarë dhe procedurën e përzgjedhjes për emërim në Gjykatën e Lartë”

Vendim i Këshillit të Lartë Gjyqësor, nr. 209 dt. 11.10.2019 “Për miratimin e metodologjisë për vlerësimin dhe pikëzimin e kandidatëve jogjyqtarë për në Gjykatën e Lartë”

Guida “Meritokracia në karrierat gjyqësore”, Instituti për Studimet Publike & Ligjore, Maj 2023